

## **NË Ç'MËNYRA ËSHTË PËRMIRËSUAR DHE DO TË PËRMIRËSOHET KLIMA E BIZNESIT NË VEND.**

---

### **KASTRIOT ISLAMI**

### **MINISTËR I FINANCAVE**

I nderuar prof. Cani, të nderuar pjesëmarrës, fillimisht më lejoni që në cilësinë e anëtarit të kabinetit qeveritar të përgëzoj Bankën e Shqipërisë, këtë institucion tashmë të pavarur, për organizmin e këtij aktiviteti ndërkombëtar, ku të gjithë aktorët shqiptarë së bashku me partnerët tanë ndërkombëtarë, do të vlerësojnë dhe do të analizojnë performancën e tranzicionit shqiptar dhe mbi bazën e leksioneve të nxjerra, do të përcjellin mesazhet dhe opinionet e tyre lidhur me politikat e mundshme ekonomike që do të sugjeroheshin për t'u zbatuar në të ardhmen në Shqipëri. Po kështu, dëshiroj të falenderoj për pjesëmarrjen e tyre të gjitha personalitetet e huaja dhe vendase, duke veçuar z. Franko Pasacantando dhe z. Kemal Dervish, të cilët për kontributin e tyre permanent në rritjen e performancës së ekonomisë shqiptare, janë dekoruar dje nga Presidenti i Republikës.

Lidhur me temën e krijimit të klimës miqësore për biznesin do të përqipem, nga këndvështrimi i Ministrit të Financave, të jem sa më realist duke mos dashur të neglizhoj as shqetësimet e biznesit e të investitorëve të huaj dhe as hapat e progresit që janë bërë nga të gjitha institucionet e shtetit. Shumica e problemeve kryesore u trajtuan nga zoti Pasacantando, në referimin e tij dhe unë bie dakord me të gjitha rekomandimet e bëra. Po kështu, studimi i FIAS, përmes një diagnostikimi të klimës së biznesit ka ngritur një seri problemesh specifike të cilave qeveria iu është përgjigjur përmes një plani veprimesh që është pjesë e një matrice integrale veprimesh, përmes të cilave adresohen çështjet kryesore të stabilitetit makroekonomik, të forcimit të sistemit financiar, të zgjidhjes së problemit të pronësisë mbi tokën, të forcimit të sistemit gjyqësor, të përmirësimit të infrastrukturës në kuptimin e përgjithshëm, të përmirësimit të qeverisjes dhe të luftës kundër korrupsionit, të thjeshtësimit e lehtësimit të procedurave të licencimit etj., etj..

Shkurtimisht, më duhet të përsëris në fillim faktin e njohur nga të gjithë lidhur me stabilitetin e kuadrit makroekonomik. Shqipëria vazhdon të ketë një rritje ekonomike të konsiderueshme me rreth 6 për qind në vit, ku ndryshimet strukturore në PBB janë më se të dukshme, duke reflektuar ndryshimet në kërkesën agregate të ekonomisë shqiptarë. Ndërkohë që inflacioni, si një tregues tjetër shumë i rëndësishëm makroekonomik, ka ruajtur tendenca të lehta rritjeje që në vitet e para të tranzicionit, objektivi i këtyre 5 viteve të fundit 2-4 për qind është arritur. Deficiti buxhetor ka ardhur gjithnjë në ulje, për të arritur në fund të vitit 2002 në vetëm 6.2 për qind e PBB-së, si rezultat i miratimit të kujdesshëm të shpenzimeve buxhetore dhe i realizimit të objektivave ambiciozë në mbledhjen e të ardhurave fiskale.

Një nga faktorët e rëndësishëm, që ka patur ndikim gjatë këtyre viteve të tranzicionit në ecurinë e zhvillimit ekonomik e të stabilitetit makroekonomik në përgjithësi dhe klimës ndaj biznesit në veçanti, ka qenë qëndrueshmëria politike. Ndonëse faktorët që kanë përcaktuar nivelin e qëndrueshmërisë politike kanë qenë me natyrë dhe me prejardhje të ndryshme, ndikimi i tyre në stabilitetin makroekonomik ka qenë i ndjeshëm, duke ndikuar njëkohësisht në ndërtimin e imazhit e të klimës për biznesin vendas dhe sidomos në drejtim të tërheqjes së investitorëve strategjikë. Pra, një nga leksionet e nxjerra nga faza e parë e tranzicionit lidhet me rëndësinë dhe me rolin e qëndrueshmërisë dhe të fragmentimit politik në stabilitetin makroekonomik dhe në krijimin e klimës për biznesin. Por, si Ministër i Financave, me këtë ndërhyrje modeste do të bashkëndaja me ju informacionin që lidhet me zhvillimet më të fundit në politikat fiskale, me marrëdhëniet me biznesin në përgjithësi, si dhe me implementimin e reformave të nisura nga administrata tatimore dhe doganore, gjithmonë në funksion të krijimit të një klime të përshtatshme e miqësore, për zhvillimin e biznesit të ndershëm dhe njëkohësisht për zgjerimin e bazës së taksueshme.

Stabiliteti makroekonomik dhe rritja ekonomike e qëndrueshme, në korrelacion të fortë midis tyre, janë realizuar duke synuar jo vetëm një ulje progresive të deficitit, por edhe përmes rritjes progresive të të ardhurave e përmirësimit të vazhdueshëm të programimit e administrimit të shpenzimeve publike. Nga ana e tyre, të ardhurat fiskale është synuar të rriten jo vetëm bazuar në rritjen ekonomike dhe në përmirësimin e administrimit, por edhe përmes konceptimit e zbatimit të një reforme që synon të ulë progresivisht barrën fiskale e të përmirësojë marrëdhëniet shtet-biznes, duke tentuar rritjen e bazës së taksueshme e njëkohësisht uljen e eliminimit e barrierave administrative. Në themel të reformave në administratat fiskale ka qenë dhe mbetet përmirësimi i vazhdueshëm i legjisllacionit tatimor e doganor, dhe përkimi i tij me standarde evropiane, forcimi i vazhdueshëm institucional i sistemit fiskal, formimi i administratave fiskale të qëndrueshme e ngritja e kapaciteteve të tyre njerëzore, modernizimi e kompjuterizimi i sistemeve, ngritja dhe vënia në funksionim e mekanizmave të pavarur të apelimit për taksapaguesit, zbatimi i procedurave administrative lehtësuese që krijojnë akses homogjen për bizneset dhe që garantojnë transparencë e integritet të aktivitetit të administratave fiskale, ngritja dhe forcimi i mekanizmave që garantojnë uljen e evazionit fiskal dhe ndihmojnë formalizimin e ekonomisë. Krijimi i klimës miqësore për biznesin është bazuar në zbatimin rigoroz dhe të njëjtë të ligjit për të gjitha bizneset, duke synuar njëkohësisht uljen e evazionit dhe formalizimin e ekonomisë, të cilat së bashku synojnë të ndikojnë në zgjerimin e bazës së taksapaguesve. Për këtë qëllim, janë parashikuar në periudhën 2003-2005 një sërë masash që ndikojnë në minimizimin e evazionit fiskal, të tilla si ngritja e strukturave të kontrollit të brendshëm, të antikorrupsionit dhe të investigimit si dhe të kontrollit *a posteriori* etj.. Në funksion të krijimit të klimës miqësore me biznesin është dhe institucionalizimi i konsultimit me biznesin për të gjitha aspektet e reformës së tij fiskale dhe nënshkrimi i mjaft marrëveshjeve të mirëkuptimit. Në këtë kuptim, po ndryshon mentaliteti i trajtimit të biznesit duke e kthyer atë në një partner të

rëndësishëm dhe duke zhvilluar dimensionin ekonomik të administratave fiskale. Një faktor nxitës i biznesit dhe i tërheqjes së investimeve të huaja në vëmendje të qeverisë dhe të mazhorancës qeverisëse, natyrisht lidhet me përmirësimin e qeverisjes në kuptimin e përgjithshëm duke filluar me forcimin e sistemit gjyqësor e deri në përcaktimin e veprimeve në luftë kundër korrupsionit, gjithmonë, në funksion të uljes së kostove parazitare për biznesin. Po kështu, janë ndërmarrë hapa në drejtim të nxitjes së investimeve të huaja në Shqipëri, roli dhe kontributi i të cilave në rimëkëmbjen e ekonomisë shqiptare mbetet i padiskutueshëm.

Është e rëndësishme të theksohet se thithja e investimeve të huaja ka qenë dhe vazhdon të mbetet prioritet i reformave ekonomike të qeverisë dhe në këtë kuadër qeveria po punon për: finalizimin e procesit të privatizimit të sektorëve strategjikë, përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës sidomos në sektorin e rrugëve, të energjisë, të telekomunikacionit etj., rritjen progresive të nivelit të sigurisë publike, thellimin e proceseve kooperuese dhe integruese në rajon e më gjerë, rritjen e burimeve të brendshme të financimit, por dhe sigurimin e granteve e të huave koncensionale e pothuajse koncensionale, të cilat do të vazhdojnë edhe për periudhën 2003-2005. Përmirësime të mëtejshme të karakterit legjislativ janë konstatuar dhe konsistojnë në përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor lidhur më investimet e huaja, në rritjen e nivelit të sigurisë për investimet përfshirë këtu dhe vendosjen e një stabiliteti ekonomik afatgjatë me politika që garantojnë këtë edhe në të ardhmen, reduktimin gradual të ngarkesës fiskale për investimet e huaja. Po kështu, është krijuar së fundmi Agjencia e Nxitjes së Investimeve të Huaja e cila synon të promovojë imazhin e ri të vendit, të ofrojë shërbime për investitorët, si dhe të ndihmojë Qeverinë Shqiptare me propozime konkrete në synimet e kësaj të fundit për përmirësimet e legjislationit në këtë fushë. Po kështu, bazuar në rekomandimet e raportit të FIAS për përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në nivel qeveritar, dikasterial apo nëndikasterial më qëllim hartimin e një plani veprimesh më hapa konkretë, duke kërkuar mbështetjen e institucioneve qeveritare përgjegjëse.

Megjithatë, jam i mendimit se në të ardhmen mbetet më shumë për të bërë në drejtim të krijimit të një klime sa më të përshtatshme për zhvillimin e biznesit në Shqipëri dhe për tërheqjen e investitorëve të huaj. Të gjitha rekomandimet e bëra në referimet e kësaj konference për çështjet dhe për rrugët më të përshtatshme, janë dhe do të jenë në vëmendjen e ekzekutivit. Edhe një herë tjetër, duke përgëzuar dhe falenderuar njëkohësisht stafin e Bankës së Shqipërisë për organizimin e suksesshëm të kësaj konference në shërbim dhe në funksion të evidentimit të performancës ekonomike në vend dhe të sfidave të së ardhmes, besoj se kjo tryezë e sotme e nderuar dhe me pjesëmarrjen e personaliteteve ekonomiko-politike ndërkombëtare, do të kontribuojë në përpjekjet për konsolidimin e mëtejshëm në të ardhmen të ekonomisë shqiptare. Faleminderit për vëmendjen.